

# Sfida 26

DHJETOR 2007

**Krijimi i mundesive dhe kushteve që personat me aftësi të kufizuara të votojnë**




**Shanse të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara**



**Nën një zë, aftësia e kufizuar bëhet më e fuqishme**



**Partneritet ndërmjet Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Agjensive e Programeve të Zhvillimit për krijimin e politikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse "Programi i granteve të vogla"**



**Raste të Gjykatës së Strazburgut për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**

Në këtë botim jemi përpjekur të publikojmë praktika ligjore të cilat përfaqësojnë me legjislacionin shqiptar, e që mund të përdoren si precedent për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në sistemin gjyqësor shqiptar.

**Fatjona është si të gjithë ne...**

Te gjithë nxenesit e duan Fatjonen. Kur hyn në klase nuk mund të mos e vesh re sa ngrohtësi ka në buzeqeshjet e femijeve. Kur shikon Fatjonen, verën se sa shumë ajo ka ndryshuar! Ajo nuk mund të krahasohet më me vajzën e ndrojtur që vitin e kaluar u integrua në klasën e parë.

# Në këtë numër

Krijimi i mundësive dhe kushteve që personat me aftësi të kufizuar të votojnë

Faqe 3

Shanse të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuar

Faqe 7

Nën një zë, aftësia e kufizuar bëhet më e fuqishme  
Partneritet ndërmjet Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Agjensive e Programeve të Zhvillimit për krijimin e politikave dhe praktikave gjithpërfshirëse “ Programi i granteve të vogla “

Faqe 15

Studimi pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar në fushën e aftësisë të kufizuar me Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Faqe 16

Raste të Gjykatës së Strazburgut për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Faqe 16

Qendra e formimit profesional Shkoder në mbështetje të Personave me Aftësi të Kufizuar

Faqe 17

Fatjona është si të gjithë ne...

Faqe 19



## Sfida 26

Revistë e përtremuajshme  
Financuar nga:  
Komiteti Suedez i Helsinkit për të  
Drejtat e Njeriut

**Swedish Helsinki Committee  
for Human Rights**

### Bashkëpunëtorë:

Bardhylka KOSPIRI  
Narbis BALLHYSA  
Florida Kalemi  
Entila ZYBA  
Brikena DEMIRAS  
Edlira GRABOVA  
Shoqata e të verbërve të  
Shqipërisë

Design and Layout  
Grafika ELZANA

Adresa:  
Rr.: “A. Z. Çajupi”, / (Bogdani)  
Nr. 15 / kati III/ Tiranë

Tel/Fax.: +355 4269426

e-mail: [adrf@albmil.com](mailto:adrf@albmil.com)

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

# Krijimi i mundësive dhe kushteve që personat me aftësi të kufizuar të votojnë

30 tetor 2007- Topalli takon përfaqësues të Institutit Republikan Ndërkombëtar dhe të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli priti në takim përfaqësuesin e Institutit Republikan Ndërkombëtar, Patrick Sheehan dhe përfaqësues të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Në takim u diskutua gjerësisht për problemet me të cilat hasen sot personat me aftësi të kufizuar, për nevojën dhe mundësitë e hartimit të një kuadri të plotë ligjor në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe integritimit të plotë të tyre në shoqëri.

Ata e njohën Kryetaren e Kuvendit me nismën e fundit për të ndërhyrë në kodin zgjedhor, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të ushtrojnë të drejtën themelore të çdo qytetari, të drejtën e votës.



Ata kërkuar rregullimin me ligj të krijimit të mundësive dhe kushteve, që këta persona të mund të votojnë.



Duke falënderuar zonjën Topalli për mbështetjen e vazhdueshme në ndihmë të personave që kanë nevojë për përkrahje, ata kërkuar që zonja Topalli të bëhet avokate e tyre në nismat për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Kryetarja e Kuvendit, pasi përshëndeti këtë iniciativë të tyre, premtoi mbështetje të plotë dhe angazhimin e saj maksimal për nxitjen e ligjeve që sigurojnë dinjitet për personat me aftësi të kufizuar. Ajo u shpreh e gatshme në mbështetje të krijimit të të gjitha kushteve për këtë grup shoqëror dhe për mbështetje ligjore të tij. Ajo u shpreh se do të punohet që, së pari, të gjitha mjediset, shkollat, insitucionet, spitalet etj, të ndërtohen apo të përshtaten në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar, në mënyrë që më pas, këto mjedise që përdoren edhe si qendra votimi të kenë kushtet e domosdoshme që personat me aftësi të kufizuar të ushtrojnë të drejtën e pamohueshme të votës.

# Shanse te Barabarta

## per Personat me Aftesi te Kufizuar

Nga data 1 Tetor deri me 6 Tetor 2007 Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar (FSHDKPAK) organizoi ne kuader te projektit “ Promovimi dhe Mbrojtja e te Drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuar ne Shqiperi” mbeshtetur nga Agjensia e Shteteve te Bashkuara te Amerikes per Zhvillim Nderkombetar (USAID), fushaten ndergjegjesuese “Shanse te Barabarta per Personat me Aftesi te Kufizuar”. Kjo fushate u realizua ne qytetet; Tirane, Durres, Vlore, Shkoder, Elbasan dhe Korçe.

Aktivitetet e kryera ne kete jave synuan te rrisnin ndergjegjesimin e strukturave qendrore dhe kryesisht atyre lokale per zbatimin e Strategjise Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuar ne afate kohore te percaktuara ne planin e veprimit te kesaj strategjie si dhe aktoreve te tjere te rendesishem te shoqerise perfshire komunitetin e biznesit dhe ate me gjere.

Plani i aktiviteteve i percaktuar paraprikisht dhe i mirekoordinuar kishte te perfshire; takime me drejtues te larte te pushtetit lokal ne qytetet respektive ( Prefekt Qarku, Kryetar Bashkie, Drejtues te Zyrave Rajonale te fushave perkatese; sherbime sociale,



---

Aktivitetet e kryera ne kete jave synuan te rrisnin ndergjegjesimin e strukturave qendrore dhe kryesisht atyre lokale per zbatimin e Strategjise Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuar ne afate kohore te percaktuara ne planin e veprimit te kesaj strategjie si dhe aktoreve te tjere te rendesishem te shoqerise perfshire komunitetin e biznesit dhe ate me gjere.

---

sherbime shendetesore, urbanistike, arsim, punesim si dhe drejtues te Dhomave te Tregtise dhe Industrise).

Te gjitha keto subjekte u njohen me pare me objektin dhe qellimin e takimit permes nje informacioni te shkruar te

derguar nga FSHDKPAK.

Duke synuar dhenien e plote te mesazhit qe kjo jave mbart, nga vete personat me aftesi te kufizuar, per drejtuesit e larte ne nivel lokal, per te marre pjese ne takimet e planifikuara FSHDKPAK ne çdo qytet krijoi nga nje grup perfaqesues.



Ky grup kishte ne perberje te tij; perfaqesues te FSHDPAK, individe me aftesi te kufizuar, familjare te tyre, perfaqesues te OJF te fushes se aftesise se kufizuar si dhe studente.

Ne takimet e zhvilluara me drejtuesit e larte te pushtetit lokal, pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e politikave ne nivel lokal u be prezent;

1. Strategjia Kombetare e Personave me Aftesi te Kufizuar, Plani i Veprimit dhe domosdoshmeria e zbatimit te tij ne afate kohore te percaktuara,
2. Problematika e aftesise se kufizuar dhe nevojat per zgjidhje te tyre. Gjate takimeve u diskutuan ceshtje te tilla si;

a. sherbimet sociale alternative per personat me aftesi te kufizuar, vleresimi dhe planifikimi i buxheteve ne nivel lokal me qellim mundesimin e ketyre sherbimeve krahas perfitimeve nga skemat e ndihmes ekonomike dhe sigurimeve shoqerore,

b. rritja e cilesise se ofrimit

**Ky grup kishte ne perberje te tij; perfaqesues te FSHDPAK, individe me aftesi te kufizuar, familjare te tyre, perfaqesues te OJF te fushes se aftesise se kufizuar si dhe studente.**



te sherbimeve shendetore dhe diversifikimi i tyre me sherbime te reja dhe shume te kerkuara si ai i rehabilitimit,

c. arsimi gjithperfshires, shanse dhe mundesi te barabarta per femijet me aftesi te kufizuar per tu edukuar ne shkollat e zakonshme,

d. domosdoshmeria e aplikimit te normave urbanistike dhe arkitekto-

*nike per personat me aftesi te kufizuar ne te gjitha subjektet publike dhe respektimi i tyre ne dhenien e lejeve te reja te ndertimit,*

*e. punesimi i personave me aftesi te kufizuar, detyrimi ligjor per rregjistrimin e tyre prane zyrave te punes si dhe monitorimi nga strukturat pergjegjese ne nivel lokal i zbatimit te ligjit per "Nxitjen e Punesimit".*

Ne takimet e zhvilluara me drejtues te Dhomave te Tregtise dhe Industrise u theksua rendesia qe ka mbeshtetja dhe partneriteti i biznesit serioz ne iniciativa te ndermara nga organizatat e aftesise se kufizuar per te ofruar sherbime per personat me aftesi te kufizuar ne komunitet.

Impaktet e ketyre takimeve do te vleresohen ne vijueshmeri, gjithsesi duhet theksuar qe ne te gjitha takimet drejtuesit lokale ishin shume te ndergjegjesuar per te zbatuar objektivat dhe detyrimet e njohura ne SKPAK.

"Decentralizimi i sherbimeve per personat me aftesi te



kufizuar eshte nje proçes qe sapo ka filluar dhe qe ne vazhdimesi do te vazhdoje te realizohet jo vetem ne saje te punes se institucioneve ne mbeshtetje te personave me aftesi te kufizuar, siç eshte Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar, por edhe mbeshtetjes se strukturave vendore per rezultate sa me konkrete dhe standarte te larta”, tha Z. Maxhit Cungu, prefekt i qarkut te Shkodres.

**Ne takimet e zhvilluara me drejtues te Dhomes te Tregtise dhe Industrise u theksua rendesia qe ka mbeshtetja dhe partneriteti i biznesit serioz ne iniciativa te ndermarr nga organizatat e aftesise se kufizuar per te ofruar sherbime per personat me aftesi te kufizuar ne komunitet.**

Ne vijim te takimit me prefektin e Elbasanit ai beri nje prononcim publik ne mediat lokale: “ Ne emer te institucionit te prefektit Elbasan i bej thirrje te gjithë drejtuesve te institucioneve qendrore ne nivel vendor ne qarkun e Elbasanit, qe te vene ne zbatim te gjitha detyrimet qe



prefekt i qarkut te Elbasanit. “Bashkepunimi ndermjet Dhomes se Tregtise dhe Industrise ne qarkun e Korçes dhe FSHDPAK do te jete me i ngushte me qellim nxitjen e punesimit te PAK, prane bizneseve private, mundesimin e sponsorizimeve te ndryshme nga DHTI ne kuader te rehabilitimit dhe gjithper-

shrjes se personave me aftesi te kufizuar”, tha Z. Ilir Selenica, Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrise, Korçe. Ne keto takime te gjithë drejtuesve iu dorezua nje pakete me materiale informative te fushates si; fletpalosje, flete-info, postera, minipostera, nje kopje e Strategjise Kombetare e Personave me Aftesi te Kufizuar dhe Plani i Veprimit. Ne te gjitha qytetet u shperndane dhe ngjiten posterat e pergatitur per kete fushate.

Mediat lokale pasqyruan aktivitetin e javes ne te gjitha qytetet. FSHDPAK pergatiti dhe nje deklarate shtypi per kete qellim.

Fushata ndergjegjesuese “Shanse te Barabarta” mbeshetur nga USAID, ishte nje mundesi per FSHDPAK dhe organizatat e tjera te aftesise se kufizuar te shprehnin drejtpersedrejti kerkesat e tyre prane drejtuesve te pushtetit lokal per tu fokusuar ne prioritetet per zgjidhje te çeshtjeve qe sot perballen personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

**Narbis Ballhysa**  
**Koordinatori Programi**  
**prane FSHDPAK**



rrjedhin ne zbatim te kesaj strategjie”, tha Z. Rezart Kovaçi,

# Nën një zë, aftësia e kufizuar bëhet më e fuqishme

Problematika e aftësisë së kufizuar ka zgjeruar gamën e aktorëve që do të punojnë në zgjidhjen e sfidave që vihen para saj. Ne të SFIDA-s u bëmë të njëjtat pyetje, disa prej nënshkruesve anëtarëve të koalicionit më të ri shqiptar, “Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi”, të cilët në programet e tyre nuk mund të lënë jashtë vëmendjes këtë problematikë, ku përjashtim bën vetëm biznesi.

## Pyetja I.

Tashmë është krijuar koalicioni shqiptar “Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi”. Ju jeni një nga organizatat firmëtare. A ka një eksperiencë tuajën të mëparshme në marrëdhënie me aftësinë e kufizuar? Çfarë vlerësuar si të domosdoshme dhe të nevojshme për të qenë pjesë e këtij koalicioni?

## Pyetja II.

Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të jenë të veçuar nga komuniteti dhe nga proceset e zhvillimit. Si organizatë anetare e KSHAKZH, si e shikoni rolin tuaj në ndryshimin e realitetit? Si mendoni të ndërthuret kjo problematikë me programin tuaj të zhvillimit?

## BARDHYLKA KOSPIRI

- FSHDPAK

### I.

FSHDPAK nuk është thjesht një nga organizatat firmëtare të koalicionit “Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi”, por është organizata që ndërmori nismën për krijimin e tij. Ndërmarrja e kësaj nisme, nuk është rastësi, por është një nga hapat progresive që FSHDPAK ndërmerr vazhdimisht në procesin e përbaljes me sfida të reja ambicioze në shërbim të realizimit të misionit të tij. Duke mbartur me vete një eksperiencë më shumë se dhjetëvjeçare me rezultate të dukshme në ndërtim partneritetesh në shërbim të çështjes së aftësisë së kufizuar FSHDPAK është gjithmonë në kërkim të nismave të reja dhe përbaljes me vështirësitë që ato bartin, sepse ka një vizion të qartë për të kuptuar se realizimi



**Realizimi i gjithëpërfshirjes sociale arrihet nëse ndërton marrëdhënie për aftësinë e kufizuar, tej kufijve të aftësisë së kufizuar.**

i gjithëpërfshirjes sociale arrihet nëse ndërton marrëdhënie për aftësinë e kufizuar, tej kufijve të aftësisë së kufizuar.

### II.

Pa dyshim që krijimi i këtij koalicioni është një mbështetje më e fuqishme në proceset gjithëpërfshirëse, gjithmonë nëse ai do të ndërtohet dhe do të funksionojë normalisht. FSHDPAK është i angazhuar tërësisht dhe ka marrë përgjegjësitë e veta për një ecuri normale të punës së koalicionit.

Sa më shumë aktorë të shoqërisë civile të kenë një zë të përbashkët aq më shumë impakt do të ketë koalicioni për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

E gjithë puna e deritanishme e FSHDPAK ka çuar në rezultate që kanë ndikuar në përmirësimin e imazhit të PAK, në ndryshimin e

qëndrimeve ndaj tyre dhe në orientimin e PAK për të rritur rolin e tyre në këto procese. Natyrisht që FSHDPAK në kuadrin e bashkëpunimit brenda koalicionit do të vazhdojë të punojë edhe më tej që misioni dhe objektivat e punës së koalicionit të zënë vend në programet e punës së secilit prej anëtarëve të tij, duke shërbyer edhe si model për nisma të tjera gjithëpërfshirëse, duke u përputhur kështu me standardet ndërkombëtare, për të realizuar më të dukshme dhe më shpejt përmirësimet cilësore të jetesës së PAK dhe familjarëve të tyre.

#### **EDLIRA PAPAANGJELI- KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**

I.  
KSHH është pjesë e disa koalicioneve kombëtare dhe atyre rajonale dhe që në fillim e ka mbështetur Koalicionin Shqiptar “Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi” pikërisht duke vlerësuar vlerën dhe efektivitetin

**KSHH në rastet e shkeljeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar mund të denoncojë këto shkelje në median e shkruar dhe elektronike si edhe mund t'i bashkangjitet Koalicionit në raste të nismave të përbashkëta për mbrojtje dhe promovim të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.**

e këtyre koalicioneve të cilat kanë fokus të caktuar në fushën e të

drejtave të njeriut. KSHH beson dhe vlerëson se edhe ky koalicion është më se i domosdoshëm dhe i nevojshëm për shoqërinë shqiptare. Sa më shumë aktorë të shoqërisë civile të kenë një zë të përbashkët aq më shumë impakt do të ketë



**Me decentralizimin e funksioneve bëhet më tepër i mundur planifikimi i veprimtarive me këtë grup dhe bashkëpunimi me shoqatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuar.**

koalicioni për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

II.  
Edhe në kuadër të Planit Strategjik të Organizatës për 2008-2010, KSHH do të fokusohet në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grupeve vulnerabël dhe në këtë aspekt edhe personat me aftësi të kufizuar do të jenë pjesë e punës së KSHH-së në të ardhmen. Më konkretisht, KSHH do të kontribuojë me ekspertizë ligjore ndaj viktimave të të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, KSHH në rastet e shkeljeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar

mund të denoncojë këto shkelje në median e shkruar dhe elektronike si edhe mund t'i bashkangjitet Koalicionit në raste të nismave të përbashkëta për mbrojtje dhe promovim të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

#### **LAVDIE RUCI- SHOQATA E BASHKIVE TË SHQIPËRISË**

I.  
SHBSH është një shoqatë e bashkive të Shqipërisë dhe mbron interesat e të 65 bashkive të vendit. Në këtë kuadër ajo e përkrahu nismën për të krijuar një koalicion për personat me aftësi të kufizuar pasi vlerëson bashkëpunimin e të gjithë aktorëve qeveritarë e joqeveritarë për të punuar për integrimin në shoqëri të këtij grupi shoqëror. Pushteti vendor e ka pasur gjithmonë në vëmendjen e punës së vet mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar duke bashkëpunuar me shoqatat e



**Dihet që edhe në këtë grup ka individë me prirje të veçanta në fusha të caktuara që mund të ndihmohen t'i zhvillojnë ato. Në këtë mënyrë ata do të ndjehen të dobishëm për veten dhe komunitetin.**

tyre. Por me decentralizimin e funksioneve bëhet më tepër i mundur planifikimi i veprimtarive me këtë grup dhe bashkëpunimi me shoqatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuar.

Është e rëndësishme të qartësojmë se është detyrë e pushtetit vendor të vlerësojë këtë grup shoqëror duke marrë në konsideratë aftësinë e kufizuar, por me synimin për t'i integruar në shoqëri sipas aftësive të tyre të veçanta.

## II.

Roli i SHBSH konsiston në ndërgjegjësimin e bashkive për të pasur në konsideratë në gjithë veprimtarinë e tyre që në bashki jetojnë e punojnë edhe persona me aftësi të kufizuar, të cilëve duhet t'u krijohen disa mundësi për t'ua bërë jetën më të lehtë. Kjo kërkon që në miratimin e të gjitha llojeve të ndërtimit, ndërtesa banimi, shkolla, e ndërtesa shërbimesh tregtare e publike në tërësi të kenë udhëkalimet dhe mjediset e përshtatshme për të gjithë njerëzit siç e kërkon edhe vetë ligji i urbanistikës, por që pak e shohim të zbatuar në Shqipëri për personat me aftësi të

kufizuar. Çështja është që të përmirësohen këto lloj ndërtimesh atje ku është e mundur për t'i shërbyer me efikasitet këtij grupi njerëzish. Kjo çështje duhet vlerësuar e programuar në planet e zhvillimit të bashkive. Që të arrihet kjo duhet biseduar e ndërgjegjësuar bashkia nga KPAK dhe SHBSH sëbashku, në takime e veprimtari të përbashkëta.

Drejtimit tjetër i punës do të jetë bashkërendimi më i mirë i

me prirje të veçanta në fusha të caktuara që mund të ndihmohen t'i zhvillojnë ato. Në këtë mënyrë ata do të ndjehen të dobishëm për veten dhe komunitetin.

Çështja është që të ndërgjegjësohen njerëzit e strukturat për të konsideruar këtë grup shoqëror për t'i krijuar mundësitë që të integrohet në shoqëri. Kjo lloj përvojë nuk ka ekzistuar në Shqipëri më parë. Por në dhjetëvjeçarin e fundit po tregohet një vëmendje më e



veprimtarive me shoqatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuar. Planifikimi në buxhetin e bashkisë dhe mbështetja e veprimtarive të shoqatave për personat me aftësi të kufizuar është një tjetër drejtim që do të ndihmojë jo vetëm këtë grup, por tërë komunitetin për t'u ndërgjegjësuar për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën e qytetit të tyre. Dihet që edhe në këtë grup ka individë

madhe, veçanërisht nga shoqatat e vendit dhe të huaja që punojnë me personat me aftësi të kufizuar. Kjo punë e mirë e nisur do të zhvillohet më tej duke u ndërgjegjësuar komuniteti për nevojën e përfshirjes së këtij grupi shoqëror duke e konsideruar këtë jo thjesht problem vetiak të tyre e të familjes përkatëse, por të ketë vlerësimin dhe kujdesin e të zgjedhurve vendorë.

## AFËRDITA SEITI – “NDIHMONI JETËN”

### I.

“Ndihmni jetën” që prej vitit 1999 është organizimi i një grupi prindërisht të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Gjithë veprimtarinë e saj qendra gjatë kësaj periudhe ia ka kushtuar të drejtave të këtij komuniteti, si dhe ndryshimit të statusit social të fëmijëve, adoleshentëve dhe grupeve të tjera mbi këtë moshë për të mundësuar integrimin e tyre në familje dhe shoqëri. Që prej krijimit ne kemi qenë pjesë e koalicioneve që janë formuar në mbrojtje të këtij komuniteti, si dhe kemi punuar për të ngritur dhe siguruar shërbime sa më cilësore për ta. Ajo që ne vlerësojmë si domosdoshmëri për të marrë pjesë në këtë koalicion ishin pikërisht ndryshimet në legjislacion dhe unifikimi i të gjitha përpjekjeve dhe mendimeve tona të përbashkëta. Fokusi duhet të zgjerohet jo vetëm te organizatat që merren me aftësinë e kufizuar, por edhe ato që ndihmojnë në fushën e të drejtave të tyre.

### II.

Është e vërtetë që PAK kanë shumë probleme ekonomike, ligjore, probleme të përshtatshmërisë, të arsimit, e të punësimit. Ne si organizatë fokusin kryesor e kemi drejtuar tek shërbimet sociale dhe shërbimet e edukimit, si një mbështetje që interferon në gjithë jetën e PAK dhe është pjesë e të drejtave të tyre. Programet tona për fëmijët me aftësi të kufizuara fillojnë që me ndërhyrjen e hershme në moshën 2-vjeçare e vazhdojnë me edukimin e tyre në

**Fokusi duhet të zgjerohet jo vetëm te organizatat që merren me aftësinë e kufizuar, por edhe ato që ndihmojnë në fushën e të drejtave të tyre.**



kopshte e shkolla, bashkë me bashkëmoshatarët, me programin e Qendrës Ditore për adoleshentë dhe të rinj, që u jep atyre një edukim profesional dhe hap rrugën e tyre për t'u integruar në jetë.

Pjesë e programeve tona është edhe familja, ajo është partnere në edukimin dhe rehabilitimin e fëmijës. Ne mendojmë se punojnë dhe jemi duke punuar për ndryshimin e mentaliteteve dhe edukimin jo vetëm të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, por edhe me



komunitetin, ku këta njerëz jetojnë. Duke ndryshuar familjen dhe komunitetin, ne mendojmë

se krijojmë një shtrat të ngrohtë që personat me aftësi të kufizuara të zhvillohen në mes të kësaj shoqërie dhe të jenë pjesë e pandashme e saj.

Në hapat që duhet të ndërmerren për të ardhmen, ky koalicion ka vendosur objektiva shumë të rëndësishme, si në drejtim të punësimit, strehimit, arsimit e më gjerë. Duke bashkëpunuar biznesi, shoqatat e bashkive, Avokati i Popullit, organizatat për të drejtat e njeriut dhe organizatat për personat me aftësi të kufizuara, zëri bëhet më i fortë dhe problematika e personave me aftësi të kufizuara bëhet pjesë e politikave shtetërore dhe e gjithë shoqërisë. Gjithmonë programet tona janë ndërthurrur me strategjinë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar dhe në kuadrin e decentralizimit të kompetencave të pushtetit vendor, bashkëpunimi i shoqatave dhe organizatave që punojnë në këtë fushë, me pushtetin vendor është akoma më i rëndësishëm, më imediat gjithmonë në funksion

të një jete më të mirë për këta persona.

## ALBI GREVA- VODA FONE ALBANIA FOUNDATION

### ”Duhet një ligj i veçantë për biznesin”

*Tashmë shoqatat e aftësisë së kufizuar janë bashkuar në një koalicion. Si e vlerësoni ju roli n e këtij grupimi?*

Jeta nuk jetohe vetëm në kryeqytet.

Njerëz me aftësi të kufizuara ka në çdo skaj të Shqipërisë. Koalicioni “Aftësia e kufizuar dhe zhvillimi” mund t’i shërbejë më mirë nevojës për mbështetje të këtij komuniteti, qoftë kjo e drejtuar ndaj shoqërisë civile apo institucioneve shtetërore. E shohim me shumë optimizëm organizimin e shoqërisë civile në kuadrin e një rrjeti në fushën e ndihmës ndaj personave me aftësi të kufizuar, bashkimin e përpjekjeve dhe kontributeve të tyre në shërbim të këtij komuniteti në nevojë. Kemi eksperiencën e mirë të bashkëpunimit me disa organizata që ne i kemi partnere të projekteve të financuara prej Vodafone Albania, por duhet

Shumë vende kanë aprovuar ligje specifike për bamirësinë, gjë e cila u krijon lehtësi bizneseve që ndihmojnë komunitete të caktuara.

thënë që ka ende shumë për të bërë. Mendoj se një prej fushave ku koalicion mund të luajë një



**Mendoj se një prej fushave ku ky koalicion mund të luajë një rol aktiv mund të jetë ajo e përmirësimit të kuadrin ligjor në mbështetje të këtij komuniteti, por nga ana tjetër edhe krijimi i një baze të dhënash e statistikash mbi nevojat e këtij komuniteti është shumë i rëndësishëm.**

rol aktiv mund të jetë ajo e përmirësimit të kuadrin ligjor në mbështetje të këtij komuniteti, por nga ana tjetër edhe krijimi i një baze të dhënash e statistikash mbi nevojat e këtij komuniteti është shumë i rëndësishëm.

*Pse gjykoni se kishte ardhur koha për këtë stad organizimi?*

Së pari, ka shumë shoqata të cilat bëjnë punë të mirë në këtë fushë, por që mungon koordinimi mes tyre. Mendoj se shoqatat mund të mësojnë mjaft nga njëra-tjetra, madje ky koalicion mundëson edhe shkëmbimin e eksperiencave me vende të



tjera. Së dyti, besojmë se ky grupim duhet të nxisë lobingun e opinionistëve, politikanëve,

shoqërisë civile, si dhe institucioneve të tjera për nxitjen dhe përpilimin e ligjeve specifike për të lehtësuar financimet e dhurimet e komunitetit të biznesit në këtë fushë.

Shumë vende kanë aprovuar ligje specifike për bamirësinë, gjë e cila u krijon lehtësi bizneseve që ndihmojnë komunitete të caktuara. Në vendin tonë, financimet për këtë komunitet bëhen mbi bazë të ligjit të sponsorizimeve, por që s’do të doja ta konsideroja sponsorizim prodhimin e karrigeve me rrota. Ka ardhur koha që shoqëria jonë të organizohet duke vlerësuar shembujt e realizuara e të sukseshëm në këtë drejtim. Ky kuadër ligjor mund të krijojë hapësira të reja edhe për aktivizimin e kësaj pjese të shoqërisë civile. Së fundmi, mendoj që eksperiencat e më shumë se një dekade i ka dhënë shoqërisë civile pjekurinë e një koordinimi që ky stad kërkon.

**Brikena Demiras**  
gazetare

**N**e kuadrin e programit 'Per Ndertimin e nje Komuniteti Gjithperfshires' qe Mobility Intenational/ MIUSA me mbeshtetjen e USAID, prej dy vitesh po aplikon ne Shqiperi, ne partneritet me Fondacionin

prindërve; grupimet nismëtarë të sapoformuar, të menaxhuar dhe drejtuar nga persona me aftësi të kufizuar.

Grantet e vogla do të mbështesnin projekte te reja, novatore dhe nisma te bashkëpunimit që synojne realizimin e objektivave te

2. Të sjellin bashkëpunimin midis shoqatave të personave me aftësi të kufizuar dhe agjensive ndërkombëtare të zhvillimit, ose/dhe organizatave lokale të zhvillimit; dhe
3. Të përmirësojnë aftësitë

## Partneritet ndermjet Shoqatave te Personave me Aftesi te Kufizuar dhe Agjensive e Programeve te Zhvillimit per krijimin e politikave dhe praktikave gjithperfshirese "Programi i granteve te vogla"



### Grantet e vogla do të mbështesnin projekte te reja, novatore dhe nisma te bashkëpunimit

Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar shpalli ne Maj 2007, konkurrim per aplikim per grante të vogla . Aplikimet duhet te vinin nga shoqatat e personave me aftësi të kufizuar (PAK); grupet e avokatisë të

meposhtem:

1. Të sjellin *praktika, politika dhe rezultate* gjithëpërfshirëse në kuadër të nismave ekzistuese ndërkombëtare për zhvillim, programeve dhe aktiviteteve te tyre në Shqipëri;

drejtuese, avokatisë dhe lobimit të personave me aftësi të kufizuar, përfshi gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar; të organizatave dhe grupeve nismëtarë të personave me aftësi të kufizuar, për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në

programet e zhvillimit. Ky program grantesh prej rreth 3000-\$ - 7000\$ kërkon që organizata te personave me aftësi të kufizuara të bashkëpunojnë me programet ndërkombëtare për zhvillim ose me organizatat e tyre partnere lokale. Vëmendje e veçantë do ti kushtohej projekteve që kanë si qëllim pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në programet ekzistuese për zhvillim.

Proçesi i formulimit dhe paraqitjes së ideve u shoqërua me një sërë takimesh dhe konsultimesh me agjensi, organizata implementuese të programeve të ndryshme të zhvillimit, kryesisht të mbështetura nga USAID si dhe OJF të aftësisë së kufizuar.

MIUSA me përfshirjen e një paneli ekspertesh ndërkombëtare, pas shqyrtimit të aplikimeve, aprovoi 5 projekte me fond të Mobility International USA dhe Agjensisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Nderkombëtar (USAID). Projektet e përzgjedhura përmbushnin objektivat e grantit dhe do të zhvillohen në partneritet me organizata zhvillimi të cilat shprehen dëshirën dhe gadishmerinë për



### **Vëmendje e veçantë do t'i kushtohej projekteve që kanë si qëllim pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në programet ekzistuese për zhvillim.**

te punuar me organizata të fushës së aftësisë së kufizuar me synim përfshirjen e problematikes së aftësisë së kufizuar në programet e tyre.

Kështu projekti i fokusuar në “Rritjen Ekonomike, Punësimin dhe Aftësinë e Kufizuar” do të promovojë bashkëpunimin ndërmjet Shoqatës Kombëtare Shqipëtare për Invalidët e Punës, EDEM – Shërbime për Tregun e Eksportit dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve – financuar nga USAID dhe

partnerët lokal të EDEM (biznese të sektorit privat në sektorin e Turizmit dhe Bujqësisë/Agrobiznesit) për të zhvilluar më tej një komunitet gjithpërfshirës biznesi që do të çojë në rritjen ekonomike dhe mundësi punësimi për personat me aftësi të kufizuar.

Projekti i fokusuar në “Implementimin e Ligjit për Arësimin Gjithpërfshirës” konsiston në krijimin e një bashkëpunimi të mirë me struktura të ndryshme të tilla si: pushteti lokal, Drejtori7në e Arsimit në Rrethin e

**Projektet e përzgjedhura përmbushnin objektivat e grantit dhe do të zhvillohen në partneritet me organizata zhvillimi të cilat shprehen dëshirën dhe gadishmerinë për te punuar me organizata të fushës së aftësisë së kufizuar me synim përfshirjen e problematikes së aftësisë së kufizuar në programet e tyre.**

Elbasanit, prindër, mësues dhe specialiste të kësaj fushe. Ky projekt do të zbatohet në bashkëpunim me zyrën “Partner për Shpresë” të World Vision Albania (WVA), e cila implementon projektet e saj në 4 komuna në zonën e Elbasanit. Misioni i WVA në Shqipëri është të punojë në partneritet me komunitetet për të vënë në jetë iniciativa që promovojnë standart të mirë jetese në familjet, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, e prekura nga varfëria dhe padrejtësia. MEDPAK Librazhd dhe projekti shqiptar “Mbijetesa e Fëmijës” i financuar nga USAID dhe implementuar nga Kryqi i Kuq Amerikan në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar në Qarkun e Dibrës do të kenë mundësinë që nëpërmjet këtij granti të vogël të ko-ordinojnë aktivitetet dhe të standartizojnë kujdesin shëndetësor për personat me aftësi të kufizuar në programet egzistuese të kujdesit shëndetësor në komunitet.

“Planifikimi familjar dhe edukimi seksual tek personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike” është një projekt i “Ndiqmoni Jetën”, Shoqata “Shpresë dhe Dashuri”; “Distrofia Muskulare” dhe “Shoqata Shqiptare për Planifikim Familiar”. Qëllimi i këtij projekti është “Ofrimi i shërbimeve të planifikimit familiar personave me aftësi të

## **Këta shembuj bashkëpunimi ndërmjet DPO-ve dhe organizatave kombëtare/ndërkombëtare të zhvillimit në Shqipëri janë në fazën e tyre fillestare por shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme të procesit që do të çojë në sfidimin e barrierave të izolimit dhe ndërtimit të një shoqërie të plotë gjithpërfshirëse.**

kufizuar mendore dhe fizike, bazuar në praktikat gjithpërfshirëse”. Stafi i organizatës së zhvillimit do të jetë pjesë e grupit të trainimit dhe do të ofrojë shërbime të planifikimit familjar dhe edukimit seksual për personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Organizata e zhvillimit është e interesuar në këtë bashkëpunim pasi pas këtij projekti, kjo organizatë do të jetë në gjendje të projektojë një shërbim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike, një grupim i papërfshirë me parë.

Inisiativa e MIUSA-s për grante të vogla mbështet gjithashtu Koalicionin Shqiptar “Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi”. Me qëllim që koalicioni të zhvillohet më tej, kërkohet një periudhë zhvillimi që të sigurojë qëndrueshmërinë e tij. Ky projekt kërkon të mbështesë fazën zhvilluese të koalicionit duke aplikuar për mbështetje financiare për të organizuar një sërë takimesh

për të arritur objektiva të tilla si: sigurimi i informacionit dhe trainimit mbi modelet e praktikës së mirë për gjithpërfshirjen e aftësisë së kufizuar; sigurimi i anëtarëve të koalicionit me mundësi për të mësuar dhe ndarë me njëri tjetrin praktikat e tyre egzistuese në gjithpërfshirjen e aftësisë së kufizuar dhe fokusimi në krijimin e frymës së ekipit dhe strategjive për zhvillimin e rrjeteve, diskutimi dhe marrja e vendimeve mbi strukturën afat-gjate dhe formatin e punës së koalicionit. Këta shembuj bashkëpunimi ndërmjet DPO-ve dhe organizatave kombëtare/ndërkombëtare të zhvillimit në Shqipëri janë në fazën e tyre fillestare por shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme të procesit që do të çojë në sfidimin e barrierave të izolimit dhe ndërtimit të një shoqërie të plotë gjithpërfshirëse.

**Florida Kalemi**  
**Koordinatorë Programi pranë**  
**FSHDPAK**

# Studimi pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar në fushën e aftësisë të kufizuar me Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

FSHDPAK me mbështetjen financiare të UNICEF realizoi një “Analizë vlerësuese të pajtueshmërisë të legjislacionit shqiptar me Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka miratuar në 13 Dhjetor 2006, në New York “Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”. Kjo konventë është dokumenti i parë ndërkombëtar i cili afirmon në mënyrë kaq të gjerë dhe gjithëpërfshirëse garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Shteti shqiptar ende nuk e ka ratifikuar këtë konventë. Në këtë kuadër FSHDPAK me mbështetjen financiare të UNICEF realizoi një “Analizë vlerësuese të pajtueshmërisë të legjislacionit shqiptar me Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”.

Analiza pati si qëllim të vendose, në plan krahasimor, jo vetëm pajtueshmërinë e legjislacionit shqiptar me standardet e Konventës së OKB për PAK, por edhe me nenet e Konventës të të Drejtave të Fëmijëve dhe Legjislacionin e Komunitetit Evropian (për aq sa ato mund të kenë ndikim në fushën dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar) duke qenë se Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe aspiron të jetë anëtare e Bashkimit Evropian.

Standardet e “Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar” u analizuan mbi baze të drejtash të grupuara, të përfshira në standardin e secilit nga nenet e Konventës së OKB-se për të drejtat e PAK. Standardi i Konventës është interpretuar si pike me vete në analize dhe është pasuruar me parashikime të ngjashme apo me të detajuara të Konventave të tjera ku shteti shqiptar është pale apo të instrumenteve të Komunitetit Evropian, të cilat vlejné të konsiderohen si standarde që duhet të arrihen nga shteti shqiptar në kuadër të procesit të stabilizimit asocimit.

Për realizimin e këtij studimi u përfshinë 2 ekspertë ligjorë Av. Holta

Kotherja dhe Av. Entila Zyba të cilat realizuan pjesën ligjore të këtij materiali dhe 2 ekspertë financiar, zj. Mirela Muca dhe zj. Irena Dano, të cilat realizuan analizën financiare të raportit.

Në mbledhjen e të dhënave u përfshinë shoqatat që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar dhe institucione

detësore, etj...

Ekspertët analizuan dhe identifikuan mangësitë ligjore dhe financiare jo vetëm në legjislacion por edhe në dokumentet politik të Qeverisë Shqiptare, që lidhen me aftësinë e kufizuar, me synim dhënien e rekomandimeve për ndërhyrje apo përmirësim të mëtejshme ligjorë (përfshirë edhe

## DISA NGA REKOMANDIMET MË SPECIFIKE TË KËTIJ STUDIMI NJXJERRIN NE PAH SE;

- Parlamenti Shqiptar duhet të miratojë ligjin e mosdiskriminimit/përfshirë edhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë të kufizuar;
- duhet të përmirësohet legjislacioni për të siguruar garantimin e të drejtës për pavarësi në lëvizje për çdo individ me aftësi të kufizuar;
- duhet të përmirësohet legjislacioni lidhur me të drejtën e aksesit për informacion;
- duhet të përmirësohet legjislacioni për të siguruar të drejtën e arsimit gjithëpërfshirës;
- duhet të përmirësohet legjislacioni në fushën e shëndetit, aftësimin dhe rehabilitimit dhe zbatimin në praktikë të shërbimeve komunitare;
- duhet të përmirësohet legjislacioni për të garantuar të drejtën për argëtim, kohë e lirë, kulturë dhe sport;
- është domosdoshmeri përfshirja dhe parashikimi i buxheteve konkrete për vënien në zbatim të legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

te administratës publike si; Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, Sekretariati teknik i Aftësisë së Kufizuar pranë MPÇSSHB, Zyra e Statistikës dhe Buxhetit në Shërbimin Social Shtetëror, KKRT, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria Arsimore Tiranë, Ministria e Financave, Bashkia Tiranë, Ministria e Transporteve Telekomunikacionit, Ministria e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shën-

aspektin financiar) dhe lehtësimin e përpjekjeve të grupeve lobuese për ratifikimin e Konventës të OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar (UNCRPD) nga shteti shqiptar.

Në plan të përgjithshëm ekspertët vlerësojnë nevojshmërinë për ratifikimin e kësaj konvente nga shteti shqiptar duke patur parasysh rekomandimet.

**Entila Zyba,**  
Avokate, koordinatore programi pranë FSHDPAK

# Raste të Gjykatës së Strazburgut për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

**Në këtë botim jemi përpjekur të publikojmë praktika ligjore të cilat përafrojnë me legjislacionin shqiptar, e që mund të përdoren si precedent për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në sistemin gjyqësor shqiptar.**

Programi Ligjor pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, ka bërë të mundur botimin e 10 rasteve ligjore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykatës së Strazburgut), duke u fokusuar në afirmimin e rasteve ligjore që trajtojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Në këtë botim jemi përpjekur të publikojmë praktika ligjore të cilat përafrojnë me legjislacionin shqiptar, e që mund të përdoren si precedent për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në sistemin gjyqësor shqiptar.

Ndër rastet e trajtuara, me të drejtë mund të veçojmë rastin e *Mihailovit kundër Bullgarisë*, në bazë të të cilit është zgjidhur me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njëjta problematikë që paraqitet edhe në legjislacionin shqiptar, qenia ende në fuqi e nenit 35 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet

**Programi ligjor pranë FSHDPAK shpreson gjithashtu që botimi i këtij materiali, të jetë fillesa për përmirësimin e legjislacionit shqiptar, vënë në një plan krahasues me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me qëllim garantimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.**

shoqërore në RSH” (i ndryshuar), në bazë të të cilit sanksionohet se “Vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë në Punë është i formës së prerë”.

Në çështjet në vazhdim janë trajtuar shkelja e nenit 3 (ndalimi i torturës), shkelja e nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri), shkelja e nenit 6 (proçesi i rregullt gjyqësor), shkelja e nenit 14 (ndalimi i diskriminimit). Gjithashtu, në këtë botim është përfshirë teksti i plotë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Rastet e publikuara në këtë botim do të ndihmojnë avokatët në lidhje me thellimin e njohurive ligjore në fushën e aftësisë së kufizuar dhe

mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie në sistemin gjyqësor shqiptar. Por nga ana tjetër ky botim do të vijë në ndihmë edhe vetë personave me aftësi të kufizuar dhe organizatave që veprojnë në këtë fushë, në njohjen e të drejtave të tyre.

Në këtë kuadër Programi Ligjor ka realizuar gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2007 trajnime për avokatë dhe juristë në 6 qytete (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Vlorë Elbasan) ku janë të përqendruara edhe zyrat e programit ligjor.

Programi ligjor pranë FSHDPAK shpreson gjithashtu që botimi i këtij materiali, të jetë fillesa për përmirësimin e legjislacionit shqiptar, vënë në një plan krahasues me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me qëllim garantimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

FSHDPAK falënderon edhe njëherë Komitetin Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, që bëri të mundur botimin e këtij materiali.

# Qendra e formimit profesional Shkoder ne mbeshtetje te Personave me Aftesi te Kufizuar

**P**rej disa muajsh Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta, projekti me i fundit i Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara, po bashkepunon me ente te ndryshme private dhe shtetore per punesimin dhe kualifikimin e personave me aftesi te kufizuar ( PAK ) qe kane kerkuar ndihme prane kesaj qendre. FSHDPAK ka gjetur mjaft mirekuptim dhe ka krijuar bashkepunim ne vazhdimesi me qendra sociale si: Hapat e Lehte, CSDC, Gruaja tek Gruaja etj.



Megjithate nje nder qendrat qe po integron mjaft me sukses PAK ne kurse trajnimi dhe formimi eshte Qendra e Formimit Profesional, e cila funksionon tashme prej disa vitesh ne qytetin e Shkodres, me nje game aktivitetesh mjaft te larmishme.



Qendra e Formimit Profesional Shkoder ka filluar aktivitetin e saj ne tetor te vitit 1993. Kjo qender u krijua si nje projekt i financuar nga Ministria e Punes dhe USAID, dhe si e tille funksionoi deri me 31.12.1998.

Me perfundimin e aplikimit te projektit, vazhdimesine e punes se kesaj qendre e mori persiper Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, nepermjet Sherbimit Kombetar te Punesimit, nen autoritetin e te cilave vazhdon punen dhe sot.

Kjo qender e zhvillon aktivitetin e saj si pjese e sistemit kombetar te formimit profesional, pra edhe krijimi i kesaj qendre eshte realizuar ne pershtatje te kerkesave te tregut te punes me fuqi punetore te kualifikuar dhe te rikualifikuar, duke i paraprire keshtu zhvillimeve ekonomike qe po kalon vendi yne, konkretisht qyteti i Shkodres.



Q.F.P. Shkoder e filloi aktivitetin e saj me kursin e kompjuterit dhe te sekretarise se zyrave me nje numer te kufizuar kursantesh dhe ne vazhdimesi e zgjeroi aktivitetin e saj, jo vetem ne gamen e trajnimeve duke iu pershtatur kerkesave te tregut te

punes dhe shijeve te punekerkuesve, por edhe duke rritur numrin e te trajnuarve.

Qendra ka rritur gamen e kurseve qe zhvillon edhe ne saje te bashkepunimit me projektin gjerman PARSH te arsimit si dhe ka rritur bashkepunimin me Organizaten Boterore te Punes nepermjet projektit ILO. Ne saje te ketyre projekteve eshte realizuar financimi i shtimit te bazes materiale te kurseve ekzistuese dhe hapja e kurseve te reja.

*Z.Jani Jovani*, Drejtor i Qendres se Formimit Profesional, Shkoder si dhe *Zj.Edlira Dani*, Kryetare e Deges Ekonomike per Qendren e Trajnimit Profesional, tregojne per Sfiden qe nje kontribut mjaft te vlefshem Qendra e Trajnimit Profesional ka dhene dhe ne trajnimin dhe formimin profesional me target persona me aftesi te kufizuara, ne menyre periodike qe nga viti 1999. Ne vazhdimesi, perkatesisht nga viti 2005-2006 jane influencuar organet vendimarrrese qe ky kontigjent te trajnohet falas.

Kete vit procesi i trajnimit ka shkuar mjaft mire, ku pervec se jane trajnuar trajneret te cilet do te zhvillojne keto kurse me metoda trajtimi psiko-pedagogjik, ne pershtatje te target grupit, eshte bashkepunuar me OJF siq jane Madonnina del Grappa, Zyra e Sherbimit Qytetar, SHIZR, ACLI, Shoqata per Edukimin dhe Integrimin e Shurdherve, Observatori Kombetar, Shkolla Speciale 3 Dhjetori etj.

Perkatesisht do te trajnohen 23 persona ne kurse te ndryshme si sekretari zyre, riparime elektro shtepiake, punime duroalumin, rrobaqepsi, punime hidraulike etj.

Aplikimi eshte bere ne muajt



Prill-Maj, prane Delegacionit BE, Tirane (Komisioni i Trajnimit dhe Formimit Profesional) si dhe ne kushtet e kualifikimit eshte percaktuar qe projekti duhet te permbaje elemente inovativ si:

- Regjistrimi i personave me aftesi te kufizuara te papune mbi 16 vjec si pune kerkues prane Zyres se Punesimit
- Pershtatja e curriculave me cilesite e target grupit
- Perfshirja e Zyres se Punesimit dhe Inspektoriatit Rajonal te Punes si tryeze institucionale qe i mbetet komunitetit

- Evidentimi i Ndermarrjeve Publike ku ne baze te legjislacionit eshte i detyrueshem punesimi i nje personi me aftesi te kufizuara


- Figura e tutorit apo e mediatorit ne procesin e trajnimit profesional, etj.
- Gjithashtu, ndertimi i ambienteve te reja me fonde te buxhetit te shtetit i ka dhene nje fryme te re ecurise se punes ne kete qender, ku pervec personave me aftesi te kufizuara po trajnohen dhe formohen profesionalisht dhe vajzat e dhunuara dhe trafikuarra, persona te komunitetit rom, jetimet dhe personat qe kane kryer denim burgimi, etj.

**Edlira Grabova**  
As/ Koordinator e Qendres se Shanseve te Barabarta, Shkoder, FSHDPAK

# Fatjona

## eshte si te gjithë ne...

“Kur hyra ne klasen e pare e ndjeva vehten shume te lumtur e te gezuar. Shoket dhe shoqet me priten shume mire dhe ne u miqesuam me njeri-tjetrin. Ata jane te gjithë shume te mire.



**Te gjithë nxenesit e duan Fatjonen. Kur hyn nuk klase nuk mund te mos e vesh re sa ngrohtesi ka ne buzeqeshjet e femijeve.**

**Kur shikon Fatjonen, veren se sa shume ajo ka ndryshuar! Ajo nuk mund te krahasohet me me vajzen e ndrojtur qe vitin e kaluar u integrua ne klasen e pare. Ja si i shpreh Fatjona impresionet e saj per shkollen, shoqet dhe mesuesen:**

Fatjona vazhdimisht aktivizohet ne oren e mesimit si dhe ndjehet mire mes shoqeve dhe shoqev te saj. Mesuesja e saj Naime Gruda pohon per Sfiden:

“Fatjona eshte nje vajze shume e dashur. Si çdo nxenes ne klase ajo ka individualitetin e saj. Fatjona meson shume, me nje deshire shume te madhe per te ecur me hapin e shoqeve dhe shoqev, te cilet e ndihmojne dhe i qendrojne vazhdimisht prane. Ndjehem vertet mire qe Fatjona arrin te komunikoj e q mire me shoket dhe shoqet e saj, dhe ne nje ambient te tille aftesia e kufizuar...pothuajse nuk ekziston”.



“Kur hyra ne klasen e pare e ndjeva vehten shume te lumtur e te gezuar. Shoket dhe shoqet me priten shume mire dhe ne u miqesuan me njeri-tjetrin. Ata jane te gjith e shume te mire. Shoqja ime me e mire eshte Elsaيدا. Ajo eshte eshe shoqja ime e bankes dhe une e dua shume. Elsaيدا me ndihmon si ne mesime ashtu dhe per gjithçka qe une kam nevoj e.

Mua me pelqen shume lenda e leximit, sepse tregon rrefime te ndryshme. Me pelqen shume edhe te shkruaj dhe te vizatoj. Kur te rritem kam deshire te punoj si gjith e te tjeret, per njerезit ne nevoj e.

Une e dua shume mesuesen time. Ajo me meson gjithçka dhe eshte nje nene e dyte per mua “

Shoqja me e dashur e Fatjones eshte Elsaيدا, e cila duke qene ne nje banke ndan çdo moment me te. Kur Fatjona shkruan Elsaيدا e ndihmon te mbaje doren drejt, mbeshtet shoqen gjate shpjegimit te mesueses dhe e ndihmon te levize gjate pushimeve.

- Fatjona eshte shoqja ime e me e mire-thote ajo. Ne mesojme dhe luajme plot lodra se bashku. Fatjones i pelqen shume te shkruaje dhe te vizatoje. Ajo do te jete bashke me ne ne mbremjen e Vitit te Ri. Fatjona eshte si ne te gjith e.

